

Myftiu i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë priti në takim kryetarin e Komunës së Prishtinës. z Shpend Ahmetin i shoqëruar nga z.Albin Kurti.

Në këtë takim Myftiu Tërnavë i falënderoi mysafirët për vizitën dhe çmoi angazhimin dhe punën që po bën kryetari Ahmeti në shërbim të qytetarëve.

Poashtu në këtë takim u diskutua për mundësinë e rifillimit të restaurimit të xhamisë Sulltan Murat në Prishtinë dhe xhamisë qendrore te Posta në Prishtinë që së shpejti do të filloj ndërtimi i saj.

Nga ana e tyre mysafirët falënderuan myftiun Tërnavë për pritjen dhe vlerësuan kontributin e myftiut Tërnavë në shërbim të qytetarëve dhe vendit në përgjithësi.